



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 14 Prot

Tiranë, më 06, 02, 2013

VENDIM Nr. 240, datë 08.02.2013

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen e datës 08.02.2013, pasi shqyrtoi "Raportin përfundimtar mbi sondazhet arkeologjike të kryer në sheshin e ndërtimit me adresë: **Lagjja Nr. 17, Rr "Ramadan Veliu", Durrës**, paraqitur nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik mbi bazën e kërkesës të Subjektit "JEDAS" sh.p.k.,

VENDOSI:

- I. Miratimin e raportit përfundimtar të sondazhit arkeologjik, të përgatitur nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Durrës për sheshin e ndërtimit të subjektit "JEDAS" sh.p.k, Lagjja Nr. 17, Rruga "Ramadan Veliu", Durrës.
- II. Të lejojë fillimin e punimeve në sheshin e ndërtimit "Godinë banimi dhe shërbimi 1-12 kate mbi tokë dhe 1 kat nën tokë", zona arkeologjike "B", Durrës, të Subjektit "JEDAS" sh.p.k.
- III. Të realizohet mbikëqyrja arkeologjike deri në përfundim të procesit të gërmimit të themeleve, bazuar në kontratën dypalëshe midis "JEDAS" sh.p.k. dhe Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik.  
Mbikëqyrja arkeologjike do të kryhet nga specialistë të Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Durrës deri në arritjen e kuotës së gërmimit të parashikuar në projekt.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

ALDO BUMÇI

MINISTËR



SEKRETAR I KKA

ROLAND OLLI



Adresa: Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,  
Rruga e Kavajës, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2272171  
Web: [www.asha.gov.al](http://www.asha.gov.al)